



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:045571
Datë: 23.10.2023
Numri i dokumentit: 04819311

C.nr. 1381/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtar Argzon Muçaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.K. nga P., Rr. “H.P.”, kundër të paditurës Ndërmarrja Publike Qëndrore “P.K.” sh. a. Rr...nr..., D., P., e përfaqësuar me autorizim nga E.A., lidhur me kompensimin e mjeteve financiare, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 13.10.2023, ndërsa me datë 23.10.2023, përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET SI E PABAZUAR në tërësi kërkesëpadia e paditësit F.K. nga P. me të cilën ka kërkuar që t'i njihet e drejta e kompensimit të diferencës në pagë nga data 30.04.2015 deri me datën 31.10.2015 në lartësi prej 492.00 euro bruto sipas diferencës nga grada 5 në gradën 6, dhe kompensimi për periudhën 01.11.2015 deri me 01.02.2022 sipas diferencës nga grada 5 në gradën 7 në lartësi prej 11.063.38 euro.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi F.K. nga P., në këtë gjykatë me datë 22.04.2020 ka paraqitur padi duke kërkuar kompensimin e mjeteve financiare nga grada 5 në gradën 6 për periudhën 04.05.2015 deri me 01.11.2015 dhe nga grada 5 në gradën 7 nga data 01.11.2015, kundër të paditurës Ndërmarrja Publike Qëndrore “P.K.” sh. a.

Paditësi përmes padisë, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë se precizuar. Ka shtuar se me datë 03.02.2014 është punësuar në P.K. në pozitën Punëtor Sporteli me gradën 5, në këtë pozitë ka punuar deri me datën 04.05.2015 pasi duke u bazuar në performancën e treguar në këtë pozitë dhe detyrave të realizuara është caktuar Arkëtar Regjional me gradën 6 nga data 04.05.2015 deri me datë 01.11.2015, përgjatë kësaj periudhe ka shtuar se nuk është kompensuar as me kontratë të re sipas pozitës të cilën e ka ushtruar dhe njëkohësisht nuk ju kanë kompensuar materialisht sipas diferencës prej 1 grade. Më tutje, ka shtuar se, me datë 02.11.2015 bazuar performancës në pozitën e “Arkëtarit Regjional” është caktuar në pozitën “Zyrtar financiar” për regjionin e Prishtinës me gradë 7. Këtë pozitë ka deklaruar se është duke e ushtruar nga data 02.11.2015 deri sot për afërsisht 5 vite dhe përgjatë kësaj kohe nuk është kompensuar me kontratë të re e as

me kompensim material sipas diferencës në nivel të 2 (dy) gradave. Në seancën e shqyrtimit kryesor e ka precizuar kërkesëpadinë, duke kërkuar nga gjykata që t'i njihet e drejta e kompensimit të diferencës në pagë nga data 30.04.2015 deri me datën 31.10.2015 në lartësi prej 492.00 euro bruto sipas diferencës nga grada 5 në gradën 6 dhe kompensimi për periudhën 01.11.2015 deri me 01.02.2022 sipas diferencës nga grada 5 në gradën 7 në lartësi prej 11.063.38 euro.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në lartësi prej 150.00-€, në emër të pagesës për ekspertizën financiare.

Përfaqësuesi i palës së paditur, përmes përgjigjes në padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk është vërtetuar me asnjë provë se mbi çfarë baze ligjore paditësi pretendon se është caktuar t'i ushtroj detyrat sipas pozitive të theksuara pasi që nuk ka ofruar asnjë vendim apo akt juridik me të cilin do të provonte se kalimi nga pozita e theksuar është bërë me aprovimin e të paditurës, ashtu siç është e përcaktuar me nenin 6 dhe 7 të Rregullores nr. 01-2456/17. Për me tepër, ka shtuar se kërkesa e tij për kompensimin e diferencës së dy gradave nuk është duke marr parasysh faktin se i njëjti ka të nënshkruar kontratën nr. 01-844/14 e datës 07.02.2014 për pozitën punëtor sporteli me të cilën janë parapara të ardhura personale sipas gradës 5 e cila kontratë është bazë për pagesën e të ardhurave personale sepse e njëjta është në përputhje me nenin 3 pika 1.11 si dhe nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Punës nr. 03-L/2012. Më tutje, ka deklaruar se mbi bazën e këtij deklarimi, të cilat në mënyrë kronologjike janë theksuar në përgjigjen në padi vërtetohet se paditësi përveç se i mungon baza ligjore e padisë e njëjta edhe është paraqitur jashtë afatit pasi që paditësi kërkon diferencë të pagesë nga dt.04.05.2015 ndër kaq që padinë e ka dorëzuar në gjykatë me dt.22.04.2020, çka rezulton që në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim absolut të kërkesë padisë ashtu që në këtë drejtim e paditura ushtron kundërshtime lidhur me parashkrimin absolut të padisë bazuar në dispozitat e nenit 78,79 dhe 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilave dispozita janë parapara kushtet dhe afatet për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve pran gjykatave.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: email-i i datës 30.04.2015 i dërguar nga M.B. për S.B., email-i i datës 26.10.2015 i dërguar nga M.B. për S.H., email-i i datës 21.03.2016, i dërguar nga B.G. për Gj.I. dhe M.B., email-i i datës 04.08.2016, i dërguar nga Gj.I. për B.G., S.D. dhe M.B., shkresa e datës 2107.2016 drejtuar S.H. nga B.G., organogrami i P.K., email-i i datës 27.10.2015, i dërguar nga M.B. për S.H., email-i i datës 26.10.2015, i dërguar nga S.H. për M.B., email-i i datës 27.12.2016, nga M.B. për Gj.I., email-i i datës 13.06.2017, nga M.B. për B.G. dhe Gj.I., email-i i datës 26.10.2015 nga M.B. për S.H., email-i i datës 01.07.2016 nga M.B. për B.G., email-i i datës 24.05.2016 nga B.M. për M.B., email-i i datës 24.05.2016 nga B.M. për Sh.A., shkresa e datës 24.05.2016, nga B.M. për Sh.A. se bashku me listën e punëtorëve të Regjioni të Prishtinës, email-i i datës 03.02.2020 nga F.K. për komisionin e ankesave, email-i i datës 17.03.2020, nga F.K. për Komisionin e Ankesave, ankesa e datës 30.02.2020 e ushtruar nga F.K. për Komision e Ankesave, përgjigjja në ankesë e dhen nga P.K.

e datës 24.07.2020 dhe e datës 24.11.2020, rregullorja për rregullimin e marrëdhënies së punës për punëtores e P.K. e datës 20.09.2017, kontrata e punës për kohë të pa caktuar e lëshuar nga P.K. Sh. a. për F.K. e datës 07.02.2014, konkursi i brendshëm për vende pune i datës 24.07.2020, vendimi i datës 24.08.2020 i lëshuar nga P.K., kontrata e punës për kohë të pa caktuar e lëshuar nga P.K. Sh.a. për F.K. e datës 31.12.2020, raporti vlerësues për shqyrtim dhe vlerësim i UD NPK sh. a. i datës 14.07.2020 së bashku me rekomandimet, email-at e F.K. për komisioni e ankesave, formulari për vlerësimin e performancës për periudhën janar - qershor 2018 i lëshuar për F.K., raportet e performancës nga viti 2015,2016,2018,2019,2020 të lëshuar për paditësin nga e paditura, raporte mujore për çdo zyre postare nga viti 2015 deri 2020, raportimi mujor nga viti 2015,2016,2017,2018,2019,2020 dhe muaj janar 2021, orët e punës në baza mujore për vitin 2015,2016,2017,2018,2019,2020 dhe muaji janar 2021 dhe ekspertiza financiare e datës 26.07.2023 e përgatitur nga eksperti financiar F.K.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në nenin 8 të LPK-së, e refuzoj kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konstatoj se në mes të palëve nuk ishte kontestuese se paditësi ishte punësuar te e paditura me datë 03.02.2014 në pozitën Punëtor Sporteli, këtë fakt gjykata e konstatoj edhe nga kontrata e punës me kohë të pa caktuar me nr. 01-844/14 e datës 07.02.2014, sipas të cilës kontratë në nenin 5 të saj grada e paditësit ishte e caktuar në nivelin 5, mirëpo, kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse ishte e drejta lidhur me kompensimin e mjeteve financiare nga grada 5 në gradën 6 për periudhën 04.05.2015 deri me 01.11.2015, dhe nga grada 5 në gradën 7 nga data 01.11.2015 e tutje.

Nga email-et të cilët paditësi i ka bashkëngjitur padisë, e të cilët janë administruar si prova në këtë çështje kontestuese, nga përmbajtja e tyre, gjykata konstaton se të njëjtit janë dërguar kryesisht nga Menaxheri Regjional i P.K. dhe Drejtori i Operativës në P.K. drejtuar Zyrës së Personelit të P.K. dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Nga përmbajtja e tyre del se, është rekomanduar apo propozuar që paditësi të emërohet fillimisht në pozitën Arkëtar Regjional, e pastaj Zyrtar i Financave.

Pothuajse, të njëjtën përmbajtje e kanë edhe email-i i datës 30 Prill 2015, email-i i datës 26 Tetor 2015, email-i datës 27 Dhjetor 2016, email- i i datës 1 Qershor 2017 dhe email-i i datës 21 Mars 2016.

Për dallim nga email-et e lartcekur, nga email-i i datës 21.03.2016 gjykata konstaton se Drejtori i Operativës në P.K., i njofton zyrtarët e tjerë se çdo ri sistemim i cili nuk e ka aprovimin e Resurseve Njerëzore dhe Kryeshefit Ekzekutiv nënkupton shkelje të rregulloreve të brendshme dhe përgjegjësi.

Nga ankesa e datës 03.02.2020, gjykata konstatoj se paditësi i është drejtuar Komisionit të Ankesave të P.K., nga përmbajtja e së cilës konstatohet se paditësi ka kërkuar nga e paditura që t'i ofrohet kontrata e re e punës, për pozitën Zyrtar i Financave.

E paditura me datë 24.11.2020 i është përgjigjur paditësit në ankesën e lartcekur, nga përmbajtja e së cilës konstatohet se paditësi është i sistemuar në pozitën e punës Punëtor Sporteli në P.K. e po ashtu, Komisioni në përgjigje të ankesës ka konstatuar se për rastin e njëjtë është vendosur duke u shpallur konkursi intern nr. 01-1230-1/20 me datë 27.07.2020 dhe punëtori në këtë rast paditësi është përzgjedhur në pozitën Zyrtar Financiar.

Nga kontrata e punës me afat të pa caktuar, gjykata konstaton se paditësi ka lidhur kontratë me të paditurën me datë 31.12.2020 në pozitën Zyrtar Financiar me gradën 7, e përcaktuar në nenin 5 të kësaj kontrate.

Gjykata e vlerësoj edhe ekspertizën financiare të datës 26.07.2023 e punuar nga eksperti financiar F.K., i cili ka konstatuar se nga përlllogaritja në diferencën e të ardhurave personale dhe atë nga data 30.04.2015 deri me datën 31.10.2015 diferenca në paga nga grada 5 në gradën 6 paga bruto është 492.00 euro, ndërsa, pagat neto 467.00 euro, kontributi pensional nga punëdhënësi 24.60, ndërsa, tatimi në paga 0 euro. Kurse, sa i përket kompensimit nga grada 5 në gradën 7 për periudhën 02.11.2015 deri me 01.02.2021 si zyrtar i financave eksperti ka konstatuar se vlera e pagës bruto është 11.063.38 euro, ndërsa, për pagat neto 8.338.60 euro, kontributi pensional nga punëdhënësi 553.17 euro kurse tatimi në pagë 2.171.61 euro. Mirëpo, këtë ekspertizë, gjykata nuk e mori parasysh me rastin e vendosjes meritore, pasi që gjykata konstaton se kërkesëpadia e paditëses duhet të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Rrjedhimisht, për shkak të mos vërtetimit të bazës juridike të kërkesëpadiës të paditësit del të jetë i paarsyeshëm vlerësimi i ekspertizës financiare.

Nga administrimi dhe vlerësimi i provave të lartcekura, gjykata konstaton se paditësi ka krijuar marrëdhënie të punës me të paditurën me datë 03.02.2014 në pozitën Punëtor Sporteli, dhe kjo kontratë është ndryshuar me datë 31.12.2020 kur paditësi avancohet përmes konkursit duke e lidhur me pastaj kontratën në pozitën e Zyrtarit Financiar.

Gjykata konstaton se paditësi gjatë periudhës kontestuese 03.02.2014 deri me datë 31.12.2020 vazhdimisht ka kërkuar avancimin e tij, fillimisht nga grada 5 në gradën 6, e po ashtu, nga grada 5 në gradën 7, mirëpo, gjatë tërë kësaj periudhe kohore, paditësit nuk i është aprovuar propozimi i bërë kryesisht nga Menaxheri Regjional i P.K. dhe Drejtori i Operativës në P.K. drejtuar zyrës së Personelit të P.K. dhe Kryeshefit Ekzekutiv. Njëkohësisht, paditësi nuk ka prezantuar para gjykatës ndonjë vendim apo akt tjetër juridik i cili do të konfirmonte avancimin e tij në gradën apo pozitën të cilën ai e pretendon, lidhur me përudhën kontestuese 30.04.2015 deri me datën 01.02.2020, dhe rrjedhimisht del se asnjëherë nuk është formalizuar pozita të cilën e pretendon paditësi.

Bazuar në pozitën e punës dhe pretendimet e paditësit, gjykata vlerëson se ligji i zbatueshëm për këtë rast është Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, i cili përcakton kushtet për themelimin e marrëdhënies së punës.

Gjykata vlerësoj se paditësi në cilësinë e punëmarrësit dhe e paditura në cilësinë e punëdhënësit kanë lidhur kontratë pune me nr.01-844/2014, të datës 03.02.2014, në kohë të pacaktuar e cila është lidhur në pajtim me dispozitat nga Ligji Nr. 03/L-212 i Punës përkatësisht me nenin 10 dhe 11, dhe se e njëjta është nënshkruar nga të dyja palët ndërgjyqëse, në të cilën parashihet se për

punën e kryer paditësi do të kompensohet me pagë të përcaktuar me gradën 5, ashtu siç përcaktohet me nenin 55 të Ligjit të Punës.

Mirëpo, i njëjti pretendon t'i njihet kompensimi nga diferenca në pagë nga grada 5 në gradën 6, e pastaj nga grada 5 në gradën 7, pasi që sipas tij ka ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë fillimisht të Arkëtarit Regjional, e pastaj Zyrtar i Financave. Por, bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se paditësi nuk ka paraqitur para gjykatës, ndonjë akt tjetër apo kontratë e cila do të konstatonte se paditësi është avancuar në pozitën të cilën e pretendon për periudhën kontestuese 03.02.2014 deri me datë 31.12.2020, përveç kontratës me nr.01-844/2014, të datës 03.02.2014, me të cilën paditësi e ka themeluar marrëdhënien e punës me të paditurën në pozitën Punëtor Sporteli me gradën 5, e cila nuk ishte kontestuese për palët ndërgjyqëse.

Ligji i Punës i lartcekur, në nenin 10 përcakton se: *“Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar.”* Ndërsa, me nenin 11 të njëjtit ligj përcaktohen kushtet që duhet të përmbajë një kontratë e punës. Ndër të tjera, në këtë dispozitë ligjore, në paragrafin 1.8 është përcaktuar si një ndër kushtet thelbësore të kontratës së punës edhe *“lartësia e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër.”*

Në lidhshmëri me dispozitat e lartcekura, Ligji i Punës në nenin 55 paragraf 1 përcakton se: *“I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.”* Ndërsa, në paragrafin 2 parasheh se: *“Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuar i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.”*

Gjykata vlerëson se dispozitat e lartcekura, në çdo rast i referohen kontratës së punës, e cila duhet të lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar, duke e përcaktuar lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër.

Në rastin konkret, palët me kontratë përkatësisht me nenin 5 të kontratës nr.01-844/2014, të datës 03.02.2014 kanë përcaktuar se paditësit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 5.

Kurse, përveç kësaj kontrate, nga paditësi nuk është paraqitur ndonjë provë tjetër, ashtu siç kërkohet me dispozitat e lartcekura ligjore. Paditësi ka paraqitur email-et e lartcekur, të cilët janë administruar me lartë, në cilësi të provave, mirëpo, të njëjtit gjykata i konsideroj si propozime për menaxhmentin e P.K. për të aprovuar avancimin e tij. Siç pohohet edhe nga vet paditësi, me rastin e paraqitjes së ankesës për Komisionin e Ankesave të P.K., i njëjti asnjëherë nuk ka pranuar konfirmim nga ky Komision, deri me datë 14.07.2020, ku në bazë të përgjigjes së Komisionit, i konfirmohet e drejta për avancim në pozitën Zyrtar i Financave.

Gjykata vlerëson se e drejta e kompensimit të diferencës në pagë, paditësit në rastin konkret do t'i takonte vetëm në situatën kur do të arrinte të argumentonte me prova relevante pranë gjykatës se kjo e drejtë është arritur përmes kontratës së punës, apo ndonjë akti tjetër i cili do të i mundësonte paditësit avancimin sipas pretendimit të tij.

Njëkohësisht, gjykata i vlerësoj edhe pretendimet e paditësit i cili pretendon se gjatë periudhës kontestuese e ka ushtruar fillimisht pozitën e Arkëtarit Regjional, e pastaj Zyrtar i Financave, mirëpo për të njëjtat pretendime, gjykata i konsideroj si të pamjaftueshme provat e paraqitura nga paditësi për aprovim të kërkesëpadisë, sepse të njëjtat nuk i argumentuan gjykatës se gjatë periudhës kontestuese, paditësit i është aprovuar avancimi në pozitë, fillimisht të Arkëtarit Regjional e pastaj të Zyrtarit Financiar.

Në lidhshmëri me të lartcekurat, gjykata i vlerësoj edhe aktet e brendshme të paditurës për themelimin e marrëdhënies së punës dhe avancimin. Lidhur me këtë, Rregullorja për Rregullimin e Marrëdhënies së Punës për Punonjësit e P.K., e datës 20.09.2017, e cila në nenin 7 paragraf 2 parasheh: *“Pas caktimit të punëtorit në vendin e sistemuar, kërkesën për sistemim të punëtorit duhet të nënshkruaj drejtori që lejon transferin dhe drejtori që e pranon punëtorin në fjalë, dhe sipas aprovimit nga KE, procedohet vendimi për sistemim në kohëzgjatje prej 6 muajve.”* Bazuar në këtë dispozitë, gjykata vlerëson se çdo lëvizje e brendshme e stafit, përveç që kërkohet të nënshkruaj drejtori që lejon transferin dhe drejtori që e pranon punëtorin në fjalë, për të njëjtin është e detyrueshme edhe aprovimi nga kryeshefi ekzekutiv. Në të kundërtën, gjykata vlerëson se, në mungesë të aprovimit të kryeshefit ekzekutiv, sistemimi i punëtorit në vendin tjetër apo pozitën tjetër është i pa mundur. Rrjedhimisht, në rastin konkret, paditësi nuk e ka argumentuar para gjykatës që sistemi i tij në pozitën tjetër të punës është aprovuar nga kryeshefi ekzekutiv, dhe në përputhje me dispozitën e lartcekur, konsiderohet se sistemi i punëtorit nuk ka ndodhur apo nuk është realizuar.

Në lidhje me pretendimin e të autorizuarit të palës së paditur, sa i përket parashkrimit të kërkesës së padisë, gjykata këtë pretendim nuk e trajtoj duke marr për bazë faktin e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, përkatësisht refuzimin e kërkesëpadisë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata mori parasysh edhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, po ashtu, edhe provat e tjera, të cilat janë administruar në shqyrtim kryesor, mirëpo, të njëjtat nuk ishin relevante dhe nuk kishin ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje kontestuese.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoj në nenin 450 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e duke u bazuar në nenin 143 paragraf 1 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr. 1381/20, datë 23.10.2023

Gjyqtari
Argzon Muçaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate